



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A NR.263/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha, kryesues, Muharrem Shala dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Av. Bejtush Isufi, i cili e përfaqëson Bojana Deniç - kandidate për Këshilltare në Asamblenë Komunale në Partesh, nga radhët e Subjektit Politik Jedistvena Srpsaka Lista (JSL) nga Parteshi, që ka të bëjë me certifikimin e rezultateve përfundimtare, në seancën e mbajtur me datë 12.11.2010 mori këtë:

VENDIM

HUDHET poshtë ankesa si e palejuar.

ARSYETIMI

Av. Bejtush Isufi i cili e përfaqëson, Znj Bojana Deniç, kandidate për këshilltare në Asamblenë Komunale në Partesh, nga radhët e Subjektit Politik Jedistvena Srpsaka Lista (JSL) nga Parteshi, ka parashtruar ankesë kundër Vendimit të KQZ-së lidhur me konfirmimin dhe certifikimin e rezultateve zgjedhore për kandidat të Asamblesë Komunale në Partesh.

Përfaqësuesi i Znj. Bojana Deniç, Av. Bejtush Isufi kërkon të ndryshohet Vendimi I KQZ-së me nr. 757/10, lidhur me mandatet e subjektit politik Lista Unike Serbe dhe të vërtetohet se Znj. Bojana Deniç të jetë këshilltare e Kuvendit Komunal në Partesh.

FAKTET

Më 05.11.2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Av. Bejtush Isufi, i cili e përfaqëson Bojana Deniç kandidate për Këshilltare në Asamblenë Komunale në Partesh, nga radhët e Subjektit Politik Jedistvena Srpsaka Lista (JSL) nga Parteshi.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur listën përfundimtare të QNR, Ankesën drejtuar KQZ-së me nr.711/10, Përgjigjjen në ankesë të KQZ-së me nr.757/10, Aktvendimin e Gjykatës Supreme me nr.730/10 si dhe Autorizimin me Prokurë të Përfaqësuesit.

ANALIZË

Jurisdiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me autorizimin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në Ligjin Nr. 03/L-256, dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-072).

Neni 106.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Rezultatet Zgjedhore) përcakton:

106.3 Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

Meqenëse KQZ ka bërë certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Komunën e Parteshit më datë 22 korrik 2010, rezultatet janë përfundimtare dhe detyruese. Prandaj, ankesea HUDHET si e palejuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 263/2010 më datën 12.11.2010

